



Pranuar / Dërguar Prilbena/Prodato Received/Delivered	18.04.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organić / Jedinica Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKIMSTKIK	3655/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.451/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.451/2023 të datës 03.03.2023 dhe të plotësuar më datë 20.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë _____, kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.451/2023 e datës 03.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi me Nr.Ref.BD-176/2 i datës 14.02.2023 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Konkursi me Nr.Reference RN00011161 i datës 15.03.2023 për pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes.
- III. Detyrohet Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndër marr veprimet juridike për sistemim të ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi të Zyrtarëve Publik.
- IV. Obligohet Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën 14.12.2022 ka nxjerr Vendim DM 1118/2022, përmes të cilit ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil si pasojë e miratimit të Rregullores Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Drejtori i Burimeve Njerëzore me datën 23.12.2022 ka njoftuar ankuesin që me Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pozita Departamenti i Shitjes është shuar, duke e njoftuar që Komisioni i Ristrukturimit konform dispozitave ligjore në fuqi do të trajtojë mundësinë e sistemimit në një pozitë të lirë ekzistuese.

Burimet Njerëzore me datën 13.02.2023 ka njoftuar disa prej nëpunësve civil të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mesin e tyre dhe ankuesin se Komisioni i Ristrukturimit në propozimin e tij do të mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara, kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve.

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 ka udhëzuar Drejtorin Menaxhues të shpall konkurs publik për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*, ndërsa me datën 15.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN0011161 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*.

Nëpunësi civil i cili në bazë të Akt Emërimit të datës 10.01.2023 ka mbajtur pozitën *Drejtor i Departamentit të Shitjes*, me datën 03.03.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 2255/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa me datën 20.03.2023 ka bërë plotësimin e ankesës duke e kontestuar edhe shpalljen e konkursit për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 08.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli me datën 23.03.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2255/2023 të datës 03.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rregulloren Nr.07-2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Organogramin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit; E-mailin zyrtar të datës 23.12.2022, 13.02.2023, Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë; Vendimin Nr.705 të datës 29.04.2022; Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit; Ligjin Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Ligjin Nr.06/L-023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-115 dhe me Ligjin Nr.05/L-080; Plotësimin e ankesës nga ankuesi të datës 20.03.2023; Kopjen e konkursit me numër reference RN00011161 të datës 15.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.03.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin Nr.Ref.BD-171/61 të datës 31.10.2022 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Shkresën zyrtare Nr.4591-1 të datës 15.11.2022 lidhur me mendimin këshillimor lidhur me projekt rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës; Vendimin Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Akt emërimit e ankuesit me numër reference 172/DSH 1; Vendimin DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Vendimin DM 37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 23.01.2023; Vendimin DM 27/2023 të datës 06.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 06.02.2023; Vendimin Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 20.02.2023, 15.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, **SEPSE:**

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton se me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është aprovuar Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e cila është paraparë të hy në fuqi me datën 01.06.2023 dhe si rrjedhojë si rezultat i kësaj ka pas shuarje të disa pozitive si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës, konkretisht pozita që mban ankuesi *Drejtor i Departamentit të Shitjes* nuk është paraparë si pozitë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pretendon se vendimi përmban shkelje esenciale të dispozitave ligjore në fuqi respektivisht të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, nuk përmban elementet e aktit administrativ ndërsa me rastin e plotësimit të ankesës i njëjti kërkon që konkursi për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve* të pezullohet apo të anulohet.

Lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e lëndës dhe me këtë rast ka konstatuar se meqenëse sipas Rregullores Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit pozita *Drejtor i Departamentit të Shitjes* nuk është paraparë si pozitë, mirëpo duke pas parasysh edhe përgjigjen në ankesë të datës 23.03.2023 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në bazë të kësaj rregulloreje janë shuar katër (4) pozita të departamenteve, ndërsa është krijuar një departament i ri, atëherë Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim juridik të përcaktuar me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, kjo për shkak që Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 ka udhëzuar Drejtorin Menaxhues të shpall konkurs publik për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, konstaton se ky vendim është nxjerr në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, respektivisht nenin 7 dhe nenin 54, si dhe dispozitave të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ngase fillimisht ka qenë obligim ligjor që në rastet e ristrukturimit, fuzionimit apo edhe shuarjes së pozitave si rezultat i organizmit të brendshëm, Komisioni i Ristrukturimit është dashur që të ndërmarrë veprimet sipas nenit 54 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit, Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka ndërhyrë direkt në punën e Komisionit të Ristrukturimit, duke penguar pa asnjë bazë ligjore veprimet juridike që do të duhej të ndërmerren nga komisioni përkatës i ristrukturimit, kështu që Vendimi me Nr.Ref.BD-176/2 i datës 14.02.2023 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit përveç që është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, i njëjti është në kundërshtim edhe me nenin 4 paragrafin 2, nenin 47, nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti është i paligjshëm po ashtu edhe në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit ndaj këtij vendimi është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN0011161 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën *Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve*, Kolegji i Këshillit, konstaton se shpallja e këtij konkursi është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, pasi që i njëjti është i paligjshëm dhe duhet të anulohet për rrethanat e lartcekura, andaj ky pretendim i ankuesit është i bazuar, sepse në momentin që është parashtruar ankesë ndaj këtij procesi ndaj vendimit të bordit që udhëzon shpalljen e konkursit për pozitën që është objekt i kësaj ankese, atëherë Agjencia Kosovare e Privatizimit është dashur të ndërmarr veprimet juridike që të pezullohen të gjitha proceset e vendimmarrjes në kuptim të nenit 130 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit,*

prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”, andaj mund të konstatohet se shpallja e konkursit për këtë pozitë është në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Në kuptim të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua Nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”* si dhe nenit 32 paragrafi 3 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *“3.Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligj”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave po ashtu vëren se ky proces është përcjell me transparencë jo të mjaftueshme, sepse në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi tjetër që ankuesi fillimisht është njoftuar që rasti do të trajtohet nga Komisioni i Ristrukturimit ndërsa ky proces nuk ka ndodhur dhe nuk është njoftuar në vazhdimësi me ecurinë e të njëjtit, kështu që mbi këto arsye Kolegji vlerëson se nuk janë respektuar parimet bazë të informimit dhe transparencës gjegjësisht nenit 24 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06.L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës”,* dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë. 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj. 3. Të drejtat e parashikuara nga ky nen, kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të të dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me çështjet e ristrukturimit ju referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenin 54 i cili ka përcaktuar se: *Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit. 4. Nëpunësi mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 52 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirin nga Shërbimi Civil. 5. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, drejtohet nga njësia e pranimit dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij*

neni, sipas rastit...." dhe dispozitave të Rregulloren (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, neni 13 ka përcaktuar se: *Raste të mbylles apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës. 2. Në rast se paraqiten rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit. 3. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar apo të shuar njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylles së institucionit. Në nenin 14 përcaktohet se: "Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse brenda 15 dite të aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori..... 3. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e themelimit i propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil siç parashihet në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit; 4. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil. 5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet. 6. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter".*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit i formuar sipas Vendimit DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 dhe i ndryshuar për vetëm një anëtar sipas Vendimit DM 37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Departamentit për të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është i obliguar që në pajtim me dispozitat e lartcekura dhe në pajtim me pikën III të dispozitivit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet juridike duke shqyrtuar mundësitë e sistemimit të ankuesit në vendet e lira ekzistuese përkatësisht propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.451/2023, datë 18/04/2023.

Ardita Përçuku-SHYTI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së